

PRILL 2023 | Nr. 26

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZYRTARIZON
BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN E ELBASANIT**





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZYRTARIZON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN E ELBASANIT

Në kuadër të synimit për bashkëpunim konkret me fakultetet e drejtësisë së universiteteve të vendit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me rektorin e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, z. Skënder Topi.

Memorandumi parashikon organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me fokus edukimin ligjor e profesional në fushën e drejtësisë, përfshirë nisma me karakter akademik e humlues, shfrytëzimin e kapaciteteve të përbashkëta për ndërtimin e programeve edukuese, që i shërbejnë komunitetit të studentëve dhe vecanërisht mundësinë e realizimit të praktikës për studentët e Departamentit të së Drejtës, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas nënshkrimit të memorandumit, Rektori Prof. Dr. Skënder Topi nënvizoi se zbatimi nis menjëherë, me leksionin e hapur të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me studentët e departamentit të së drejtës.

“Ne kemi firmosur shumë marrëveshje me institucione vendase e të huaja por e sotmja mendoj se është një mbështetje shumë e madhe, që vjen nga një institucion i lartë kushtetues siç është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Përveç aktiviteteve të përbashkëta, leksioneve të hapura, kjo marrëveshje parashikon edhe që studentët më të mirë të zhvillojnë praktikë mësimore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një eksperiencë e vyer, që do u shërbejë atyre për të ardhmen profesionale.”, u shpreh Rektori Topi.



“Memorandumi që nënshkruam sot ka tre qëllime kryesore, së pari prezantimin e punës dhe funksioneve të ILD-së, diçka që në fakt duhej ta kishte bërë që në fillim secili nga ne, institucionet e reja të drejtësisë, në mënyrë që opinionin publik të kuptojë funksionet dhe rolin tonë në arkitekturën e sistemit të drejtësisë, sipas parashikimeve të reformës në drejtësi.

E dyta, studentët e drejtësisë do kenë mundësi që të kryejnë praktikë mësimore pranë ILD-së,

një mundësi e mirë, që i ndihmon të shohin direkt si monitorohet puna e gjyqtarëve e prokurorëve.

Së treti, përveç aktiviteteve të përbashkëta, vetë pedagogët e studentët do kenë mundësi të përgatisin mendim të kualifikuar profesional për ILD -në sipas kërkesës, duke ndihmuar mes të tje-rash edhe në përhapjen e kulturës juridike në komunitet”, tha z. Metani.





Në nisje të leksionit me studentët e departamentit të së drejtës së Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, dekania e Fakultetit Ekonomik Prof. As. Dr. Imelda Sejдини vlerësoi punën e ILD-së, që duke qenë institucion krejt i ri, ka arritur të ndërtojë nga fillimi standarde pune, një proces sfidues, që u nënvizua edhe nga përgjegjësi i Departamentit të së Drejtës, Prof. Dr. Arbër Gjeta.

Gjatë leksionit me studentët e departamentit të së drejtës së Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, z. Metani bashkëbisedoi mbi mënyrën sesi të rinjtë e shohin sistemin e drejtësisë, funksionimin e tij, përfshi institucionin, që është përgjegjës për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve e prokurorëve të çdo niveli në vend, Inspektori i Lartë të Drejtësisë.





Studentëve iu shpërndanë fletëpalosje prezantuese të ILD-së nga Qendra Europiane, si pjesë e bashkëpunimit të ILD me OSHC-të, që monitorojnë institucionet e reja të drejtësisë.





ROLI MBIKËQYRËS I ILD-SE NË SISTEM: INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ARTUR METANI TAKON AMBASADOREN AMERIKANE YURI KIM

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një takim pune me ambasadorën e SHBA-ve në Shqipëri, znj. Yuri Kim, mbi ecurinë e punës së ILD-së dhe përpjekjet e institucioneve të drejtësisë për forcimin e besimit të qytetarëve tek drejtësia. Ambasadorja Kim bëri këtë postim në Twitter mbi takimin me z. Metani.

“Ambasadorja e SHBA-ve Yuri Kim u takua me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Artur Metani, i

cili drejton një nga institucionet kyçe të reformës në drejtësi. Roli i ILD-së në mbikëqyrjen e disiplinës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe anëtarëve të Këshillave është thelbësisht kritik për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

SHBA-të do të vazhdojë të ndihmojë në forcimin e institucioneve të drejtësisë, siç është ILD-ja, teksa ato forcohen për të çuar më tej përpara integrimin e Shqipërisë në BE.”





SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

“Sektori i ankesave dhe marrëdhënieve me publikun” është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut.

Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Pjesë e këtij sektori është edhe Koordinator për të drejtën e informimit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas

komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

*Gjatë muajit **Prill 2023**, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur :*

- **23 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
- dhe **10 telefonata me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

Gjatë depozitimit të një ankesë



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Prill 2023, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 13 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuarit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

PRILLI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Prill**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **56** ankesa, **53** nga qytetarët dhe **3** të paraqitura nga institucione.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Prill 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

34 vendime verifikimi, nga të cilat:

- ⇒ **21** vendime verifikimi (praktika të ILD-së);
- ⇒ **13** vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

HETIME

1 vendim fillim hetimi disiplinor për **1** magjistrat

2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për **5** magjistratë

1 vendim vazhdim hetimi për **1** magjistrat

2 kërkesa për procedim disiplinor për **2** magjistratë

ARKIVIME

173 vendime arkivimi nga **221** praktika të shqyrtuara:


- ◆ **59** vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ankesa të ardhura në ILD);
- ◆ **49** vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);
- ◆ **65** vendime arkivimi pas verifikimit, nga të cilat:
 - ⇒ **10** vendime arkivimi pas verifikimit (ankesa të ardhura në ILD);
 - ⇒ **55** vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD)

69 vendime arkivimi nga **107** ankesa të trajtuara (ankesa të ardhura në ILD)

104 vendime arkivimi nga **114** ankesa të trajtuara (dosje të mbartura nga ish KLD)

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Prill** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **26** ankues, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në standat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në standat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë 262 shpallje publike.

**INFORMACION**

Për shkak të rikonstruksionit të godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvendoset për një periudhë kohore në adresën Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit).

Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë cdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.

Pritja e qytetarëve do të kryhet në katin e parë të institucionit.



MJEDISI SI ÇËSHTJE E PËRBASHKËT E DREJTËSISË EUROPIANE

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori pjesë në aktivitetin e radhës së Rrjetit Europian të Shërbimeve të Inspektimit (RESIJ), në kuadër të bashkëpunimit e shkëmbimit të eksperiencës për mbrojtjen e ambientit nga autoritetet kombëtare të inspektimit të drejtësisë.

Aktiviteti ku morën pjesë nga ILD këshilltaret Isida Koka dhe Mimoza Koçiu, u mbajt në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Portugalisë, në Lisbonë, nën kujdesin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, njëkohësisht zv. kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. José Lameira.





Drejtues të autoriteteve penale e administrative, nga Prokurori i Republikës, agjensisë portugeze e mjedisit, inspektoratit të përgjithshëm i bujqësisë, detit, mjedisit dhe administrimit të territorit, të shërbimeve të policisë që kanë përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së mjedisit, të gardës kombëtare të Portugalisë paraqitën kompetencat ligjore dhe rezultatet e punës në mbrojtje të mjedisit.

Raste konkrete u paraqitën nga anëtarë të Gjykatës së Lartë të Lisbonës.

Raste specifike të ndjekjes penale por edhe të përgjegjësisë civile për çështje të mjedisit u paraqitën nga kryetari i Gjykatës së Apelit të Portos, anëtarë të kësaj gjykate dhe prokurori i Republikës.




PRILL 2023

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kom-
bit", Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)